

**Nr. 11118-02526-00-2013 i Regj. Themeltar**  
**Nr. 00-2016-643 i Vendimit**

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Ardian Dvorani	Kryesues
Arjana Fullani	Anëtare
Andi Çeliku	Anëtar

Në datën 10.03.2016 mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen Administrative me nr.11118-02526-00-2013 akti që ju përket palëve :

PADITËS:	SHOQËRIA “****” SH.P.K
	SHOQËRIA “****” SH.P.K
E PADITUR:	DEGA E DOGANËS SHKODËR
	DREJTORIA E PËRGGJITHSHME E DOGANAVE
	SHOQËRIA “****”

**OBJEKTI:**

Shpërblim dëmi jashtë kontraktor të ardhur si pasojë e cënimit të markës tregtare B-52 nga të paditurit në shumën 2.000.000 lekë.

Marrjen e masës së sigurimit të padisë si vijon:

Vendosjen në qarkullim të lirë dhe çlirim të mallrave në deklaratat doganore R7526, R7527, R7528, R7529, datë 07.11.2012.

Lejimin e kryerjes së çdo procedure import-eksport për mallin pije joalkoolike energjitike B-52 sipas markës tregtare të regjistruar me nr.11992 deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Pezullimin e nxjerrjes dhe ekzekutimit të akteve me kërkues të paditurin

Shoqëria “\*\*\*\*”, që bllokojnë veprimtarinë tregtare

për artikullin pije joalkoolike energjike B-52 sipas markës tregtare të regjistruar me nr.11992 deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Pezullimin e cënimit dhe shkeljes së të drejtave të markës tregtare B-52 të regjistruar me nr.11992 deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Baza Ligjore: Neni 31, 90, 202 e vijues të K.Pr.Civile,

neni 608, 625,640 e vijues të K.Civil,

nenet 115, 116/b,118 e vijues të K.Pr.Administrative,

neni 118 të VKM nr.205 datë 13.04.1999,

Ligji 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor”,

Ligji 9947 datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”,

VKM nr.1706 datë 29.12.2008

“Për miratimin e rregullores për regjistrimin e markave tregtare të shërbimi”.

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**, me vendimin nr.Regj 3543 (21234-06849-51-2012), datë 16.11.2012 ka vendosur:

Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke detyruar palën e paditur Dega e Doganës Shkodër dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave që të vendosin menjëherë në qarkullim të lirë dhe të çliroj mallrat e pasqyruara në deklaratat doganore R7526,R7527, R7528, R7529, datë 07.11.2012, si dhe të lejoj kryerjen e çdo procedure import-eksportit për mallin pije joalkoolike energjike B-52 sipas markës tregtar të regjistruar me nr.11992 deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

**Gjykata e Apelit Shkodër**, me vendimin nr.22, datë 28.02.2013 ka vendosur:

Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Shkodër, për gjykimin e çështjes dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Apelit Tiranë.

**Kundër vendimit nr.22, datë 28.02.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër**, ka paraqitur ankim të veçantë pala paditëse shoqëria “\*\*\*” sh.p.k, me anë të të cilit kërkon prishjen e vendimit dhe lënien në fuqi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Pala paditëse e argumenton pretendimin e saj, për këto shkaqe:

Së pari: Sipas kërkesave të nenit 60 të K.Pr.Civile, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka marrë një vendim duke u nisur nga momentet e ngutshme që nuk mund të presin duke vendosur sigurimin e padisë të kërkuar nga paditësi.

Gjykata e Apelit në shqyrtimin e ankimit nuk merr në konsideratë absolutisht kërkesat e nenit 60 të K.Pr.Civile, por për më tepër në diskutimin e çështjes i lejon vetes të dëgjoj palët dhe në fund vendos moskompetencën e saj për shqyrtimin e çështjes.

Dej qartë se kemi të bëjmë me një boshllëk në arsyetim, pasi në fakt sigurimi i padisë është marrë duke patur parasysh një sërë elementësh të theksuar shumë qartë në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke u nisur nga kërkesat e nenit 202 e vijues të K.Pr.Civile.

**Gjithashtu kundër vendimit nr.22, datë 28.02.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër**, ka paraqitur ankim të veçantë pala e paditur Dega e Doganës Shkodër, me anë të të cilit kërkon prishjen e vendimeve dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

Pala e paditur e argumenton pretendimin e saj, për këto shkaqe:

Gjykata e Apelit Shkodër nuk e gjene veten kompetente për shqyrtimin e çështjes dhe ky vendim nuk gjene mbështetje në asnjë dispozitë ligjore të K.Pr.Civile dhe si i tillë nuk i shërben zgjidhjes së çështjes.

Gjykata bazuar në nenin 468 të K.Pr.Civile duhet të prishte vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe të vendoste pushimin e gjykimit, pasi nuk kishte pse të vazhdonte gjykimin sepse kemi mungesë objekti për faktin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk është kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Gjykata e Apelit nuk mori në shqyrtim pikat e tjera të ankimit që kanë të bëjnë me gabimet proceduriale të bëra nga shkalla e parë.

Gjykata në argumentimin e saj për marrjen e masës së sigurimit të padisë nuk ka marrë në konsideratë Kodin Doganor dhe dispozitat zbatues të tij.

**Gjithashtu kundër vendimit nr.22, datë 28.02.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër**, ka paraqitur ankim të veçantë pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me anë të të cilit kërkon ndryshimin e vendimit dhe dërgimin e çështjes për gjykim asaj gjykate.

Pala e paditur e argumenton pretendimin e saj, për këto shkaqe:

Gjykata e Apelit Shkodër në mënyrë të pambështetur në ligj vendosi të mos marrë në shqyrtim ankimin e ushtruar nga administrata e doganore ndaj vendimit të ndërmjetëm për masën e sigurimit të padisë, duke argumentuar se meqenëse çështja e themelit ishte dërguar për gjykim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kompetente për shqyrtimin e ankimit ndaj masës së sigurimit të padisë është Gjykata e Apelit Tiranë.

Ky vendim nuk gjene mbështetje ligjore pasi në asnjë dispozitë të K.Pr.Civile nuk është parashikuar ndonjë kushtëzim në përcaktimin e gjykatës së apelit e cila do të shqyrtoj ankimin ndaj vendimit të masës së sigurimit të padisë, në varësi kjo të gjykatës së rrethit e cila po shqyrton çështjen e themelit.

Në rastin objekt gjykimi vendimi i masës së sigurimit të padisë është marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrjedhimisht kompetente për të shqyrtuar në shkallë të dytë këtë vendim është Gjykata e Apelit Shkodër, pavarësisht faktit nëse është një vendim i ndërmjetëm apo vendim përfundimtar.

#### KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Ardian Dvorani dhe diskutoi çështjen në tërësi,

#### V Ë R E N

Vendimi nr.22, datë 28.02.2013 i Gjykatës së Apelit Shkodër është i bazuar në ligj, prandaj duhet të lihet në fuqi.

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**, me vendimin nr.Regj 3543 (21234-06849-51-2012), datë 16.11.2012 ka vendosur:

Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke detyruar palën e paditur Dega e Doganës Shkodër dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave që të vendosin menjëherë në qarkullim të lirë dhe të çliroj mallrat e pasqyruara në deklaratat doganore R7526,R7527, R7528, R7529, datë 07.11.2012, si dhe të lejoj kryerjen e çdo procedure import-eksportit për mallin pije joalkoolike energjike B-52 sipas markës tregtar të regjistruar me nr.11992 deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

**Gjykata e Apelit Shkodër**, me vendimin nr.22, datë 28.02.2013 ka vendosur:

Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Shkodër, për gjykimin e çështjes dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në arsyetimin e saj Gjykata e Apelit Shkodër arsyeton se”

*“Për padinë e themelit është deklaruar moskompetenca dhe çështja i është dërguar për gjykim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa masën e sigurimit të kësaj padie e ka vendosur gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

*Pra rezulton se në këtë gjykatë dhe as në atë të Rrethit Shkodër nuk ka padi për gjykim.*

*Në këto kushte vendimi i masës së sigurimit të padisë, për një padi që gjykohet në Gjykatën e Tiranës duhej të merrej në atë gjykatë dhe jo në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër”.*

**Kundër vendimit nr.22, datë 28.02.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër**, ka paraqitur ankim të veçantë pala paditëse shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k, pala e paditur Dega e Doganës Shkodër dhe pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të cilët kërkojnë të vendoset sipas arsyetimit në pjesën hyrëse.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vëren se palët të cilët kanë bërë ankim rezultojnë se i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me Rekurs dhe nuk kanë bërë ankim të veçantë sipas rregullave të përcaktuara në nenin 62 dhe 443 të K.Pr.Civile.

Në këto kushte dosja është regjistruar në Gjykatën e Lartë si padi për shqyrtim themeli dhe nuk është kaluar për gjykim sipas procedurës së përcaktuar në ligj.

Në rastin konkret rezultojnë se kompetente për shqyrtimin e çështjes është Gjykata e Apelit Tiranë, në kushte kur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë po shqyrtohet padia e themelit, si Gjykatë që ka kompetencën lëndore.

Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi nr.22, datë 28.02.2013 i Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili ka shpallur moskompetencën për gjykimin e kësaj çështje, duke e dërguar në Gjykatën e Apelit Tiranë, duhet të lihet në fuqi.

#### PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 7-13 të ligjit nr.49, datë 03.05.2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”

#### V E N D O S I

Lënen në fuqi të Vendimit nr.22, datë 28.02.2013 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Tiranë, më 10.03.2016